



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2023:259484

Datë: 21.03.2025

Numri i dokumentit: 07023692

PKR.nr.202/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti për Krime të Rënda, Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari Xhemajl JUSUFI, me bashkëpunëtoren profesionale Arbenita DËRGUTI, në çështjen penale kundër të pandehurit E.M., për shkak të veprës penale: Dhënia e ryshfetit nga neni 422 paragrafi 1 të Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (*tutje si: KPRK*), sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda, PP.I.nr.156/2023 të datës 05.12.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 12.03.2025 në prezencë të Prokurorit të Shtetit Fetije Bajrami, i pandehuri E.M. si dhe mbrojtësi i tij sipas autorizimit me shkrim, avokat Shyqyri Sylja, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 21.03.2025 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

E.M., me nofkën “Q.”, nga i ati M., e ëma H., e vajzërisë H., i lindur me datë, në Novi Pazar, ku edhe tani jeton në Rr.”Zlatiborit”, nr.8, Serbi, i pa martuar, ka të kryer magjistër i Ekonomisë, i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal, boshnjak, Shtetas i Serbisë.

ËSHTË FAJTOR

Sepse,

Me datën 23.11.2023 rreth orës 09:14 minuta, në magjistralen Mitrovicë – Vushtrri në mënyrë të tërthortë i ka dhënë dhuratë personit zyrtarë, në mënyrë që ai person të veproj në kundërshtim me detyrën e tij zyrtare, ashtu që i pandehuri drejtonte automjetin të markës Kamion MAN me regj NP....., të cilin e ka ndal policia e trafikut, zyrtari policor R.I., për shkak të kundërvajtjes, ku të pandehurit E.M. ia kërkon dokumentet për verifikimin e identitetit të tij dhe dokumentet e kamionit, atëherë i pandehuri ia jep dokumentet dhe në dokumentet kishte futur një

kartëmonedhë prej 5 euro me nr. serik ND4252771105, ku polici e pyet a i ke harruar këto para, atëherë i pandehuri i ka thënë “*këto para janë për ty për kafe vetëm lirom nga kundërvajtja*”.

Me këtë ka kryer veprën penale: Dhënia e ryshfetit nga neni 422 paragrafi 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në mbështetje të nenit 1, 4, 7, 17, 20, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 44, 69, 70 dhe 422 të KPRK-së, dhe neneve 242, 270, 364, 449, 450 dhe 452 të KPP-së, të akuzuarin e:

G J Y K O N

- I. Dënim me gjobë në shumë prej 500.00 (*me fjalë: pesëqind euro*), euro, të cilin dënim obligohet ta paguaj në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi. Në rast se i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë në afatin e caktuar, Gjkata do të veprojë në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të KPRK-së, ashtu që të pandehurit, dënimin me gjobë do t’ia zëvendësoj në dënim me burgim duke llogaritur për çdo 20 (njëzetë) euro gjobë të papaguar, me një (1) ditë burgim.
- II. Dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.
 - Në kuptim të nenit 44 të KPRK-së dhe me pëlqimin e të pandehurit, dënimi me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 800.00 (*me fjalë: tetëqind euro*) euro, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar ta paguajë në afat prej 60 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i akuzuari nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, Gjkata do të veprojë në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të KPRK-së, ashtu që të njëjtit dënim me gjobë do t’i zëvendësohet me dënim me burgim duke llogaritur për çdo 20 (njëzetë) euro gjobë të papaguar, me një (1) ditë burgim.

Gjkata, në mbështetje të nenit 76 paragrafi 2, nën paragrafi 2.4 të KPRK-së, të pandehurit E.M. i:

S H Q I P T O N

- III. Dënim unik me gjobë në shumë prej 1,300.00 euro (*me fjalë: njëmijë e treqind euro*), të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi. Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, Gjykata do të veprojë në bazë të nenit 43 të KPRK-së, ashtu që dënimin me gjobë do t'ia zëvendësoj me dënim me burg, ku një (1) ditë burgim do t'i llogaritet me 20 (njëzetë) euro.
- IV. Në mbështetje të nenit 270 paragrafi 1 të KPP-së, Gjykata urdhëron konfiskimin e përhershëm të kartëmonedhës prej pesë (5) euro ne numër serik ND4252771105. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, obligohet t'i merr nën administrim sendet e konfiskuara. Agjencia, sipas ligjit, ka të drejtë që sendet e lartcekura (paratë) t'i administroj në përputhje me ligjin për Agjencinë.
- V. Obligohet i pandehuri që të paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej tridhjetë (30) euro si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit të paguajë shumën prej pesëdhjetë euro (50), të gjitha këto në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë–Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur Aktakuzën me numër PP.I.nr.156/2023 të datës 05.12.2023, kundër të pandehurit E.M. për shkak të veprës penale Dhënia e ryshfetit të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 12.03.2025, në të cilën kanë qenë të pranishëm Prokurori i Shtetit Fetije Bajrami, i pandehuri E.M., si dhe mbrojtësi i tij sipas autorizimit me shkrim, avokat Shyqyri Sylja.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, i pandehuri ka deklaruar se e ndjen veten fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet, se e kupton natyrën dhe pasojat juridike të pranimin të fajësisë, pranimin e fajësisë e bënë në mënyrë vullnetare, pa presion dhe pas sqarimeve të mjaftueshme nga ana e gjykatës për pasojat dhe benefitet e pranimin të fajësisë, ndërsa lidhur me

sanksionin penal, ka mbështetur fjalën e mbrojtësit dhe ka shtuar se ka gabuar, nuk do të përsëritet më, ka qenë hera e parë që është ndaluar nga Policia e Kosovës.

Prokurori i Shtetit, lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se: konsideron se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë, pranimi është bërë në mënyrë vullnetare, pa presion dhe pranimi mbështetet në provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës, ndërsa lidhur me sanksionin penal, i ka propozuar gjykatës që si rrethanë rënduese të ketë parasysh peshën e veprës penale, se kjo vepër hynë te kapitulli i veprave penale të korrupsionit, të cilat janë në rritje e sipër, ndërsa si rrethana lehtësuese të merr parasysh pranimin e fajësisë që në seancë fillestare, të njëjtin ta shpallë fajtorë dhe ta dënoj sipas ligjit.

Mbrojtësi i të pandehurit, avokat Shyqyri Sylja, lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklaroi se: pas konsultimeve të mjaftueshme me të pandehurin konsideroj se i njëjti pranimin e fajësisë e bëri vullnetarisht, pa presion apo premtim, dhe se pranimi i fajësisë mbështetet edhe në shkresat e lëndës, andaj i ka propozuar gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë, ndërsa lidhur me sanksionin penal, i ka propozuar gjykatës që me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, të merren parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese si, është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin, relativisht i ri, nuk ka asnjë vepër penale, pendimin e thellë, sjelljen e tij korrekte, premtimin se më nuk do të përsërisë veprime të tilla, gjendjen ekonomike, dhe në mungesë të rrethanave rënduese i ka propozuar gjykatës që të njëjtit ti shqiptoj një dënim minimal me gjobë dhe një dënim të kushtëzuar me të cilin do të arrihet në tërësi qëllimi i dënimit.

Gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar i pandehuri, e në mbështetje të nenit 242 të KPP-së, në këtë drejtim vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të njëjtin. Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit, mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykatë si: Raporti fillestar i incidentit, i datës 23.11.2023; Procesverbal i marrjes në pyetje për të dyshuarin E.M., i datës 23.11.2023; Vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve, i datës 23.11.2023; Vendimi për kundërvajtje, i datës 23.11.2023; Raporti i policit E.D., i datës 23.11.2023; Procesverbali i marrjes në pyetje për dëshmitarin R.I., i datës 23.11.2023; Raporti i oficerit R.I., i datës 23.11.2023; foto dokumentacioni, si dhe shkresat tjera të lëndës.

Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë e tyre dhe pranimit të fajësisë, vërtetohet përtej çdo dyshimi se i akuzuari ka kryer veprën penale që i vihet në barrë.

Gjykata ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në mënyrë vullnetare, dhe se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, duke iu tërhequr vërejtja të pandehurit se pas pranimit të fajësisë, ai nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, por vetëm sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë së të pandehurit dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale Dhënia e ryshfetit nga neni 422 paragrafi 1 të KPRK-së, e për të cilën veprën penale është përcaktuar dënimi me gjobë dhe me burgim deri në pesë (5) vjet.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave rënduese dhe lehtësuese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së. Si rrethana rënduese, gjykata gjeti dashjen e lartë të kryerësit në kryerjen e veprës penale. Ndërsa, si rrethana lehtësuese, gjykata e ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale, faktin se i njëjti ka shprehur keqardhje të sinqertë para gjykatës dhe bashkëpunimin e të akuzuarit në të gjitha fazat e procedurës penale.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se shqiptimi i dënimit me gjobë dhe shqiptimi i dënimit me burg, i zëvendësuar me gjobë ndaj të pandehurit, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Po ashtu, Gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, që t'i parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Po ashtu, ky dënim do të shërbejë si masë preventive që në të ardhmen i pandehuri të përmbahet nga çfarëdo veprimi që është i dëmshëm për shoqërinë në përgjithësi.

Kryetari i trupi gjykues, me pëlqimin e të pandehurit, dënimin me burgim efektiv e ka zëvendësuar me dënim me gjobë në kuptim të nenit 44 të KPRK-së.

Vendimi për konfiskim

Gjykata ka vendosur si në pikën katër (IV) të dispozitivit të këtij Aktgjykimi dhe ka konfiskuar në mënyrë të përhershme kartëmonedhën në vlerë prej pesë (5) euro, bazuar në dispozitën e nenit 270 paragrafi 1 e lidhur me nenin 19, paragrafi 1, nën paragrafi 1.38, pika 1.38.1 të KPP-së, duke vlerësuar se kjo kartëmonedhë ka qenë mjet i kryerjes së veprës penale.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449, 450 dhe 452 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e paushallit Gjyqësor, ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 36 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit nr.08\L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Andaj, gjykata duke u bazuar në nenit 242, 270, 364, 449, 450, dhe 452 të KPP-së, nga arsyet e lartcekura, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti për Krime të Rënda

PKR.nr.202/2023, datë 21.03.2025

Zyrtarja ligjore
Doruntina BEKA

Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari
Xhemajl JUSUFI

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të Aktgjykimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palët kundërshtare.